



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 47, Datë 23.03.2022

MBI

**PAJISJEN ME ÇERTIFIKATË TË GARANCISË SË ORIGJINËS PËR IMPIANTIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE “HEC BANJË”, TË SHOQËRISË
“DEVOLL HYDROPOWER” SH.A. PËR PERIUdhËN 01.01.2021 – 31.12.2021**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 16, pika 6, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; nenit 14, të Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme, miratuar nga bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) me vendimin nr. 229, datë 20.12.2019 dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.03.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Mbikqyrjes dhe Autorizimeve, me nr. 382/3 prot., datë 18.03.2022, “Mbi pajisjen me Çertifikatë të Garancisë së Origjinës për impiantin e prodhimit të energjisë elektrike “HEC Banjë”, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a. për periudhën 01.01.2021-31.12.2021”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 345 prot., datë 02.03.2022 ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me Çertifikatë të Garancisë së Origjinës për HEC “Banjë” për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021.
- Referuar kërkesës së shoqërisë, sasia e energjisë elektrike e prodhuar nga HEC “Banjë” për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021 është 258,712 MWh, por sasia e energjisë elektrike që do të merret në konsideratë në këtë vendimmarrje është sasia faktike prej 258,632 MWh, e prodhuar nga HEC “Banjë” për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021, e raportuar nga OST sh.a., në shkresën nr.1721/1 prot , datë 16.03.2022.
- Në kuptim të nenit 16, pika 6, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” dhe nenit 11, pika 3, të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, Garancia e Origjinës lëshohet bazuar në të dhëna të kuptueshme dhe

informacion të duhur për të certifikuar origjinën e energjisë elektrike të furnizuar nga prodhuesi, si dhe të dhënat e matura të çertifikuara nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 132, datë 10.08.2020, miratoi kualifikimin e impiantit të prodhimit të energjisë elektrike “HEC Banjë”, të shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a., si dhe pajisi me Çertifikatë të Garancisë së Origjinës impiantin e prodhimit të energjisë elektrike “HEC Banjë”, të shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a., për një afat 12-mujor.
- Referuar nenit 14.2, të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anullimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, pas lëshimit të çertifikatës së parë të garancisë së origjinës, çdo aplikues që paraqet në ERE një kërkesë për Çertifikatë Garancie Origjine do të depozitojë në ERE për qëllime të këtij aplikimi vetëm dokumentacionin që ka pësuar ndryshim referuar kërkesave të nenit 7, të kësaj rregulloreje.
- Sa rezulton nga kërkesa e shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., nuk është bërë me dije ndonjë ndryshim në Impiantin prodhues “HEC Banjë”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të pajisë me Çertifikatë të Garancisë së Origjinës, impiantin e prodhimit të energjisë elektrike “HEC Banjë”, të shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a. për një periudhë 12 – mujore, (01.01.2021 – 31.12.2021), për sasinë e prodhuar të energjisë elektrike 258,632 MWh.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në gjykatën administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI